


BIBLIOTEKA
SHTETIT

81H-32

K29

ALFRED KANINI

PAS
MJEGULLES
novela



814-52

K 29.

ALFRED KANINI

PAS MJEGULLES

novela



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

S I R E N A T

Matanë dritareve qëmtonte një shi i imtë dhe deti dremiste duke lëshuar vezullime të hirta. Transoqeaniku «Tirana» po hynte në port ngadalë dhe me një pamje madhështore.

«Ky shi të prish punë», tha me vete Martini duke e ndjekur me sy transoqeanikun që lëvizte pa u ndier midis anijeve të tjera. Atij iu duk sikur përshëndetej me ta dhe sikur u kërkonte ndjesë që kishte munguar për një kohë të gjatë në port. Dikush thirri: «Bëji një gozhdë tetëshe» dhe Martini ndoqi me interes akustimin¹ e tij. Martini mendoi se ai do të niste biseda për rrugët e gjata që kishte bërë gjatë atyre muajve. I erdhi për të qeshur nga një mendim i tillë i çuditshëm dhe pastaj nisi të vështronte sheshin e madh të kantierit, nëpër të cilin lëviznin njerëz. Shiu i imtë qëmtonte pa u ndier mbi kuvertat e vaporeve dhe kullat e elektrovincëve dhe pastaj zbriste mbi skeletin e hekurt dhe të përmbysur të një anijeje të madhe. Ngjyrat e hirta ishin lëshuar si një mbulesë e bezdisshme mbi montuesit dhe Martini përsëri mendonte se ai shi u prishte punë. Herë-herë nga skeleti i anijes metalike ngriheshin flakërima elektrodash, po montatorët dukeshin sikur s'ia varnin shiut. Mbi skeletin e hekurt me përjashtim të disa vajzave askush nuk e ndjente shiun.

Martini vuri re midis tyre edhe vajzën e mikut të tij të vjetër, kapedanit të «Fanit».

«Përse i është mbushur mendja kapedanit ta sjellë

1) Akustim — lidhja e anijes në port

vajzën në kantier? mendoj. Ajo mund të ndiqte studimet ose të hynte në një punë më të përshtatshme.» Martini vuri re se ajo i zgjati disa elektroda një montatori dhe u kthye te shoqet duke futur duart në xhepa dhe duke ngjeshur kokën në supe.

«Shumë shumë ato mund të bëjnë vetëm punën e një nxënësi, vetëm t'u mbajnë montatorëve elektrodën. Por, ta hajë dreqi, u inatos me vete, ato kanë kategorinë e tretë të saldatorit!»

Martini vështroi përsëri vajzën e kapedanit të «Fanit» dhe u mundua t'i kujtonte emrin. (Një ditë më parë ai ia dinte mirë.)

«Më duket se e quajnë Eliza, mendoj, ose e quajnë Eli, ose Elvira, ose... Qenke shumë nervoz, o plak Martin» i tha vetes. Ai e kuptoi se ishte bërë nervoz që në mëngjes. Elizën ai e kishte mbajtur në prehër kur kishte qenë e vogël dhe atë mëngjes nuk ia kujtonte dot me saktësi emrin.

«Unë mund t'i lë të mbajnë edhe elektrodën, tha me vete, por kjo është një punë fare qesharake. Atij nuk mund t'i besohet se kapedani i «Fanit» e kishte prurë vajzën në kantier, sepse mendonte që atje ato s'mund të bënin asnjë punë tjetër, veçse të thjeshta. «Po ç'gjë tjetër mund t'u besohet atyre, mendoj. Ato i kanë futur vetëm sepse politikisht duhet të marrin pjesë edhe femra në prodhim.» Martini kujtoi se si e kishte sjellë Xhema të bijën në kantier. Xhema ishte fonditor i vjetër dhe, kur u vendos që në kantier të vinin edhe vajza, u përpoq t'i mbushte mendjen së shoqes që ta fuste edhe ai të bijën, sepse aty do të bënin vetëm punë të lehta. «Ja, sa t'u zgjatin montatorëve elektrodën, i kishte thënë, e ç'mund të bëjnë tjetër? Kantieri nuk është uzinë, në uzinë është ndryshe, punë sustash, kurse kantieri do krahe dhe krahe të fortë.»

«Por, tha me vete Martini, kjo nuk mund të lejohet. Nuk mund t'ua paguajmë rrogën kot. Më mirë t'i shpie në repartin e sanajve. Aty të paktën mund të lyejnë me bojë.»

Papritur vuri re se vajzat kishin lëvizur nga vendi

dhe po grindeshin. Eliza ishte kapur me Vanin dhe po mundohej t'i hiqte nga duart saldatricen. Natyrisht ajo as që mund t'ia arrinte kësaj, sepse Vani ishte sa një monument, por Martinit, iu duk se aty po ndodhte diçka e papëlqyer. Me siguri vajzat ishin grindur me montatorët. Ai vuri re Vanin që u ngrit më këmbë, tundi dorën në ajër dhe lëvizi nëpër shesh tamam si një monument. E donte shumë Vanin. Ai ishte një djalë i ri, shumë i urtë dhe mund të ngrinte një pllakë çeliku 200-kilëshe, pa iu dridhur fare gjunjët! Martini vuri re se Elizës iu afrua Ruzhdiu. Seç i tha dhe atij iu duk sikur po i jepte diçka për të punuar. Në fakt ai ia kishte zgjatur saldatricen vajzës së Xhemës, Martinit iu duk sikur ai i tha Elizës: «Ngrije këtë pllakë dhe vendose në bord. Nuk peshon më shumë se 130 kile.» Eliza u mundua ta ngrinte, por as që e lëvizi dot nga vendi dhe tregoi me dorë një vinç. Martinit i erdhi për të qeshur, ndërsa Ruzhdiu bëri me dorë një gjest jo të hijshëm dhe vajti në punë të tij. Martinit nuk i kishte hyrë dot në zemër Ruzhdiu, megjithëse kishte kohë në kantier dhe ishte shumë i fortë.

U hap dera dhe në dhomë hyri Vani.

— Martin, — tha ai — hajde sqaroi ato.

— Ç'ka ndodhur, Vani? — pyeti Martini.

— Nuk e di. — Vani uli kokën me drojtje sikur të mos ia falte vetes që ishte inatosur. — Në fund të fundit jepu ndonjë punë. A i sheh se po kalben në shi me duar në xhepa?

— Pandeh se mund të bëjnë ndonjë punë, Van? — pyeti Martini.

— Unë nuk pandeh asgjë, Martin! — tha ai dhe ngriti supet. — Ato duan të punojnë dhe kanë nisur të grinden. Thuaju ndonjë gjë, Martin.

Martini nganjëherë e humbte durimin, por në përgjithësi ishte njeri i qetë. Ai i tha.

— Mirë, do të vij t'u them ndonjë gjë.

Kur dolën dhe iu afruan skeletit të anijes, vajzat iu dukën me të vërtetë të inatosura.

— Xha Martin, — i tha Eliza duke i dalë përpara,

— nëqoftë se mendoni se kemi ardhur për të parë se si punojnë montatorët e tu, atëherë më mirë po ikim fare.

Martini e vështroi një copë herë në sy. Ai ende nuk i kishte mbushur të pesëdhjetat dhe megjithatë në kantier pandehnin se ishte plakur. Nganjëherë ai provonte në sy të të gjithëve forcën e tij të jashtëzakonshme dhe të tjerët e vështronin me habi. Këtë ai e bënte vetëm që t'u mbushte mendjen se nuk ishte aspak i plakur. Vetëm një ditë ai vuri re se që mbushur me thinja dhe u kujtua se, që kur kishte filluar punën në kantier, kishin kaluar 27 vjet. Atëherë kishte qenë një djalë shumë i ri, i fortë dhe me një palë krahë aq të fuqishëm, sa të gjithë hamejtë e portit e vështronin me zili. Kur ishte i vogël, ai kishte shumë dëshirë të gjuante peshk me të atin, po, kur ai vdiq në det, atëherë e ëma iu lut që të mos merrej me gjuetinë e peshkut. Dhe erdhi në kantier që të bënte një punë dhe të ndodhej, afër detit. Atij i lindi dëshira të bëhej ndërtues anijesh. Atëherë as që mund të mendohej se do të ndërtonte anije, por në një kohë të shkurtër ai zotëroi të gjitha profesionet e kantierit dhe u bë montatori më i mirë. Vetëm se në kantier ata riparonin peshkatorët e drunjta dhe Martini nuk kishte shumë punë. Koha e ndërtimit të anijeve metalike në Shqipërinë e viteve të para të pasçlirimit ende nuk kishte ardhur. Sapo kishte filluar ndërtimi socialist i vendit. Por a e dinte djaloshi Martin se ëndrra për ndërtimin e anijeve ishte e të gjithëve, a e dinte se krahas transformimeve të mëdha shteti socialist do të ecte në rrugën e një zhvillimi të vullshëm dhe pa dyshim do të ndërtoheshin edhe anije? Këtë sigurisht ai nuk mund ta dinte. Në kantier nisën të vinin njerëz të tjerë, sollën edhe disa anije metalike dhe ai tani merrej me rimontin e tyre. Dhe askush nuk e dinte se mbi konturet e tyre të hekurta djaloshi Martin kishte nisur të plekste një ëndërr të bukur të ndërtimit të anijeve.

Martini e hoqi vështrimin nga fytyra e vajzës së kapëdanit dhe e hodhi larg në det.

«Në kantier kanë sjellë disa vajza, mendoi, dhe ato

vetëm mund të tundin xhufkat e flokëve apo të të vësh-
trojnë pa drojtje me një palë sy të zes si të kësaj vajzës
së kapëdanit.»

Ai vështroi shinë që qëmtonte butë-butë dhe i mër-
zitshëm tha me vete. «Por ne, ta hajë dreqi, nuk ke-
mi vetëm hallin e tyre, neve na duhet të mbarojmë
anijen mirë dhe shpejt dhe pastaj ta vrasim mendjen për
to.»

Martini përfytyroi montatorët kur vendosën të mba-
ronin anijen në një kohë të shkurtër duke punuar edhe
jashtë orarit. Kur u montua skeleti, ndodhte që ata e
linin punën në mes të natës. Nganjëherë Martini e vësh-
tronte Vanin e fuqishëm që shkrofëtinte si kalë, por nuk
e jepte veten.

«Ç'thua, Martin, kjo është një punë e rëndomtë»,
i thoshte ai kur Martini kërkonte ta zëvendësonte në
saldim. Sa herë i zëvendësoi ai montatorët në saldime?
Ata ia linin me vështirësi elektrodën dhe ai punonte me
një mjeshtëri të rrallë, duke i bërë ata ta admironin.
Skeletin e anijes e përfunduan brenda një kohe të shkur-
tër dhe u përgëzuan nga drejtorja. Njëri nga konstrukto-
rët shprehu dyshimin nëse ishte e qëndrueshme një punë
aq e shpejtë! Martini i siguroi se montatorët e tij nxir-
nin vetëm punë të qëndrueshme dhe të pastër. Dhe pas
kontrollit teknik doli se ata kishin bërë me të vërtetë
një punë të bukur.

Por ja, në kantier u kishin sjellë disa vajza, sikur
nuk kishin halle të tjera, por duhej të merreshin me to.
A mund t'u besonin atyre vajzave në montimin e anijes?

Shiu i imtë u binte pa u kuptuar mbi flokë dhe mbi
supe dhe Martini i vështroi në heshtje. Dukej sikur men-
djen e kishte vetëm në fytyrën e nervozuar të Elizës, por
ai në fakt mendohej të hynte në mendimet e të gjitha
vajzave.

«Asnjëherë në jetë nuk kam pandehur se do të kem
të bëj me të tillë montatorë,» mendoi.

Vajzat prisnin me durim nën shinë e imtë që qëm-
tonte ngadalë.

— Dëgjo, moj vajzë, — ia nisi ai me zë të qetë. —

Këtu puna nuk është dhe aq e lehtë dhe ju vetëm mund t'u sillni saldatorëve elektrodën dhe të lageni kot në shi. Por a mund të quhet punë kjo?

— Jo, natyrisht — tha vajza e Xhemës.

— E pra, — tha ai — unë mendoj që më mirë ju të kaloni në repartin e sanajve. — Ai heshti dhe vështroi nga deti. Pastaj u kthye nga të gjitha. — Do t'ia mbush mendjen sekretarit që ju të kaloni në repartin e sanajve. Aty nuk do ta kaloni kohën kot, sepse gjithë ditën do të lyeni sanajt me bojë.

— Por, — tha me habi Eliza — ne kemi mbaruar kursin për saldatore.

— S'prish punë — tha Martini.

— Prish shumë punë, xha Martini! — tha Eliza. Vani ishte ngulur si një pilotë betoni dhe vuri re se ajo nisi të inatosej prapë. — Unë jam saldatore e kategorisë së tretë, a e di këtë, xha Martini?

Gjer në atë kohë në kantier askush nuk ia kishte bërë fjalën dy Martinit me përjashtim të sekretarit të partisë, i cili dinte t'ia kthente mendjen, kur atij i mbushesh për ndonjë gjë. Por ai e vështroi vajzën në sy, dhe as që kishte ndër mend t'i vërsulej me të sharat e fondit të fjalorit të tij të vrazhdë. Kjo natyrisht, e habiti Vani, sepse ai e dinte që Martini edhe pse e kishte mik kapedanin e «Fanit», nuk para pyeste, kur të shante, Martini e vështroi edhe një copë herë vajzën në sy dhe vendosi të largohej. Bëri disa hapa, pastaj u ndal papritur.

— Dëgjo, moj vajzë e kapedanit — i tha. — Më mirë shkoni te sanajt. Është më mirë për ju të shkoni te sanajt. Aty mund të bëni një punë me duk.

Vani i habitur diç deshi të thoshte por plaku u largua nëpër sheshin e lagur. Atëherë Vani mendoi se atë ditë ai nuk duhej të ishte dhe aq në rregull.

— Ne as që u sqaruam — tha vajza e Xhemës duke vështruar të tjerat. — Ai s'na tha se ç'duhet të bëjmë, po të mos pranojmë të shkojmë te sanajt.

— Jua tha copë — tha Ruzhdiu që poshtë skeletit të anijes.

Vani i hodhi një vështrim të papërcaktuar.

— Fluturonte një tufë patash — se kush tha që poshtë skeletit të anijes! — dhe një udhëtar i pyeti...

— Eh, lëre! — tha një tjetër poshtë skeletit të anijes.

— Martini na i përzuri patat.

— Mos e tepro, surratpelikan!

— Më mirë trego përrallën e mbretit që luante me peta.

— Ej, surratpelikan!

Vani u doli përpara vajzave dhe iu drejtua Elizës. Por zëri që poshtë skeletit të anijes ia mbylli gojën.

— Dhe e para e patave...

— Mos na folë më për patat — tha zëri tjetër poshtë skeletit të anijes.

— E para e patave i tha se nuk ishin një tufë patash. por...

— Dhjetë vajza — tha zëri tjetër.

— Mos më ndërprit, o surratpelikan!

— Më mirë ikni — tha Vani duke iu drejtuar Elizës.

— Ikni, ai është plakur dhe është bërë i çuditshëm. Këtu të gjithë do t'ju duken të çuditshëm. Duhet ta dini se në kantier detar nuk kanë punuar kurrë ndonjëherë vajza. Por megjithatë Martini është një plak i çuditshëm.

— Ai nuk është aspak i çuditshëm — tha Eliza.

Shpatullat e gjera të Martinit tundeshin në sfondin e mugët dhe Eliza nuk ia ndau sytë, gjersa ato u fshehën diku pas pirqjeve me hekura në bregun e detit.

2.

Kur bënte mot i mirë, Martini ngrihej herët dhe ngulej në bregun e detit. Në mugëtirën e mëngjesit konturet e transoqeanikëve mezi shquheshin dhe Martinin i dukej gjithnjë sikur çuçurisnin me njëri-tjetrin. (Në mugëtirë zakonisht ëndrrat nisin e davariten, ndërsa për Martinin atë kohë nisnin të merrnin udhë të shqetësuar.)

Ai ishte ngritur herët dhe qëndronte buzë detit, duke parë dritat e transoqeanikëve që lëkundeshin në ujë.

«Një ditë me siguri do të ndërtojmë transoqeanikë, mendoj. Në qoftë se anija do të na dalë mirë, ne me siguri një ditë do të ndërtojmë edhe transoqeanikë.»

Ai e hoqi vështrimin nga deti dhe e hodhi në skeletin e anijes që dukej si një masë e madhe dhe e errët.

Kishin ende shumë punë për të bërë poshtë në kallume, në hambarë, pastaj niste puna në bordet dhe në të gjitha këto kërkoheshin specialistë të zotë që merrnin vesh nga ndërtimi i anijeve. Po kush nga ata kishte marrë vesh nga ndërtimi i anijeve? Shumë shumë ata ishin marrë vetëm me remontin e atyre që kishin importuar. Dhe, natyrisht, kjo anije do të sillte edhe përvojën e një pune të tillë.

«Por, mendoj ai i mërzhitur, për të ndërtuar anijen, na kanë sjellë ca vajza.» Ai nxori një psherëtimë dhe kujtoi se si ngulte këmbë sekretari i partisë për t'i futur vajzat në ndërtim, ndërsa ai e kishte kundërshtuar gjer në grindje. Ato mund të montonin ndonjë gjë në kuvertë, por në kallume dhe në brinjët e anijes as që mund t'u besohej.

«Përse të mos u besohet, ë? tha me vete. Në kursin e tyre ishin edhe dy djem dhe megjithatë unë u kam gjetur punë.»

Ai e dinte mirë si ishte puna. Mbi konturet e anijeve gjithnjë kishin punuar njerëz të fuqishëm dhe ai kishte montuar mes atyre burrave me forcë jo të zakonshme, të cilët mund të mbanin fare mirë ngarkesa të rënda. (Dhe ai mendonte se vetëm ata mund të mbartnin edhe ëndërrën e ndërtimit të anijeve.)

«Është e vërtetë, mendoj, që tani forca nuk hyn dhe aq shumë në punë, por, për të ndërtuar anije, duhen vetëm burra, dhe burra të fortë.»

Martinit iu kujtuan ata dy djemtë që kishin mbaruar kursin. Ata i dukeshin si dy cironj të thatë, që nuk ishin në gjendje të lëviznin as një copë hekur 20-kilsh.

«Megjithatë unë i pranova, mendoj. Pse i pranova, ë?» Djemtë i futën të punonin në brinjët e anijes, megjithatë askush nuk i vështroi me habi. Ai përfytyroi kohën kur sanajt nga deti i ngrinin me krahë. Atëherë nuk